



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 543 Prot.

Tiranë, më datë 26.09.2025

**VENDIM**

**Nr. 488, datë 26.09.2025**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 26.09.2025:

**VENDOSI**

1. Miratimin e Sondazheve Arkeologjike për projektin “Vlerësimi i Parkut Arkeologjik të Bylisit. Hartimi i projektit të detajuar të Qendrës Multifunkionale, Master Plani i pikave të interesit, Parkimi dhe Rrethimi i Sigurisë i Parkut (Qytetet Antike të Bylisit dhe Klosit”, me aplikues ABKONS dhe zhvillues **Ambasada Italiane, me rekomandimet:**
  - Të realizohet një sondazh arkeologjik shtesë në pjesën e parkimit e dedikuar për personat me aftësi ndryshe;
  - Sondazhet do të mbikëqyren nga DSHA dhe Parku Arkeologjik Bysli-Kos, ku do të hartohet raportimi ditor;
  - Aplikimi i rezultateve të sondazheve të kryhet brenda 30 ditëve, nga miratimi I sondazheve arkeologjike;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Joli MITROJORGJI**

